



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal  
01 Nr.060/01-9169/1  
Dt.29.06.2020  
D r a g a s h

Në bazë të neneve 17 e 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, në seancën e VI-të/2020 të Kuvendit Komunal të Dragashit, të mbajtur më 29.06.2020, pas njoftimit paraprak, merret ky:


## V E N D I M


- I. **MIRATOHET** Draf i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023 dhe zhvillimi i Diskutimit Publik për këtë dokument zhvillimoro-buxhetor.
- II. Diskutimi Publik do të zgjatë deri më 11.09.2020 (e premte) me një takim përmbyllës në sallën e Kuvendit Komunal të Dragashit, duke filluar në ora 10,00.
- III. Teksti i Draftit Kornizës është transparent në web-faqen e Komunës Dragash (linku "Shpalljet"-konsultim publike, në email-adresën burim.aliu@rks-gov.net), ku, në ndërkohë, edhe adresohen vërejtjet apo plotësimet eventuale gjatë fazës së Diskutimit Publik.
- IV. Për implementimin e këtij Vendimi obligohen Drejtorati për Ekonomi, Financa e Zhvillim në bashkëpunim me kryesuesin e KK-së dhe kryetarin e Komunës-Dragash.
- V. Për hapat e ndërmarr njoftohet Kuvendi Komunal-Dragash.

I dërgohet :

- Kryetarit të Komunës Dragash z.Shaban Shabani,
- Drejtoratit për Financa, Ekonomi e Zhvillim-Dragash, drejtorit Valon Shabani,
- Z.Burim Aliu, zyrtar kryesor financiar-Dragash, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH  
Kryesuesi  
Betim Merdiu





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosova



**Kuvendi Komunal Dragash**  
Skupstina Opstina Dragas  
Municipal Assembly Dragash

---

## **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE** **2021 - 2023**

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Dragashit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2021-2023, të dhëna nga MF (Ministria e Financave) përmes Qarkores buxhetore 2021/01 për Komunitet si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufij të fillestar të buxhetit komunal për vitin 2021 dhe parashikimet për 2022-2023. Korniza afatmesme buxhetore ( KAB ) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Dragashit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2021-2023 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe

# **Përmbajtja**

## **I. Hyrje**

## **II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme**

## **III. Korniza Fiskale**

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Parashikimi i të hyrave vetanake komunale për vitet 2021-2023

3.3 Limitet fillestar sipas qarkores 2021/1

3.4 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2021-2023 (tabelat: 7,8,9,10)

## **V. Programi komunal per investime publike(PIP)**

5.1 Viti aktual 2020


5.2 Parashikimi për vitin 2021-2023

## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2021-2023 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## **II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2021-2023 nga Strategjia Zhillimore Komunale**

Komuna Dragash gjendet në pjesën jugore të Kosovës, rajoni i Prizrenit. Është njëra nga komunat me pak e zhvilluar vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson kesaj lidhje jo të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit sepse lidhe me nje drejtim. Komuna Dragashit ka gjithsej 36 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna ka 35,000 banorë të organizuar në 6,219 ekonomi familjare .

Ka,1,301 biznese që operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën Dragashit, afërsisht 2/3 e tyre merren me veprimtari tregtare, 5% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 20% në prodhimtari te ndryshme, pjesa tjetër në transport.

Administrata e Komunës së Dragashit në aspektin e administrimit është e organizuar në qender dhe permes zyrave lokale që ofrojnë shërbime për komunitetin sa i perket dhendjes civile, nga të cilat ,një është brenda ndertesës komunale të qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 4 të tilla në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën Dragashit i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë, bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si Qarkoret Buxhetore Komunale 2021 (I & II) të lëshuar nga Ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Planit zhillimor te Komues se Dragashit.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Dragashit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrimtë një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attribute binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Dragashit:

## **1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirsim, kushtve në arsimin fillor dhe atë të mesëm )
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

## **2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i tereneve të reja sportive

## **3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

## **4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2021-2023 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

### III. Korniza Fiskale Komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkethehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet , nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative.** Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Dragashit në periudhën afatmesme buxhetore 2021-2023 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

- **OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE**

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2021 – 2023 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve” dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklarata të Misionit të Programeve . KAB 2021 – 2023 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2021/01 e cila sfond të vetindhekontekst ka prioritet e programevedhekursimet e shpenzimeve. Është pjesë për bërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afatmesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të Planifikojmë të hyratdhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vitetera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

- **Objektivat e Komunës së Dragashit:**

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastructures së qytetit
- Zhvillimi i sferes së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferes së Kulturës, Sportit dhe Rinis
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Zhvillimi i turizmit malor

- **Objektivat shtetërore**

- Përkrahjes dhe krijimit të parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit;
- Zhvillimit të kapitalit njerëzor;
- Rritjes së mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Siq mund të shihet objektivat e Komunës janë të lidhura ngusht me objektivat e shtetit të Kosovës



## **Ky dokument ka përqëllimtë:**

- Promovojë disiplinën fiskale dhe të prezantojë vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore.
- Të prezantojë politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritare të Qeverisë.
- Të sigurojë një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat.
- Të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë nivel të ulët të deficitit fiskal.

## **Objektivat:**

### **a).Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve**

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimali burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve më prioritet për realizim

### **b). Rritja e shpejtë e të ardhurave**

- Rritja e efikasitetit në inkasim
- Zgjerimi i bazës tatimore

### **c).Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve**

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë
- Përparësia nga blerja me shumicë
- Përmirësimi i specifikimit për mallra dhe shërbime
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat me afat të gjatë

### **d). Zhvillimi i aftësive**

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore
- Përdorimi gjerë i kompjuterit
- Profesionalizimi i shërbimeve
- 

### **e).Ekonomia**

- Zhvillimi i strategji së Komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural

## Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat

- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Shqyrtimi i planit të punës 2020
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2021
- Përgatitja e Kornizës së shpenzimeve afatmesme 2021-2023
- Shqyrtimii përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi

## Udhëzimet kryesore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë:

(a) **LIMITET** e grandeve që do t'i caktojë Qeveria Qendrore për Komuna

(b) Buxheti duhet të jetë I **BALANCUAR**. Kjo do të thotë se Komuna **NUK MUND** të bëjë planin për shpenzime e cilat e kalongrandet e lejuara dhe nuk mund të përgatisë buxhetin deficitar.

## Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale ( politikës së të ardhurave si nga grandit i qeverisë, të hyrave vetjake komunale si dhe shpenzimeve. Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2021 – 2023 është parapare ndërmarrja e një vargmasash duke filluar nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve publike – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së e deritë marrja e masave konkrete në realizimin e të Hyrave në nivel Qendror dhe Lokal . Psh.

- Kontroll më i ngushtë dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifatat e mbledhura në nivel lokal.
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës

### 3.1 Korniza makroekonomike e Komunës është sipas Qarkores nr. 2021/01 për Komuna

Korniza Afatmesme Makroekonomike e Komunës sonë është në përputhje me Kornizën Afatmesme Makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve që dalin nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH). Në përgjithësi mund të thuhet se fondet nga Grandi Qeveritar dhe Të Hyrat Vetanake Komunale për momentin nuk paraqesin potencial të mjaftueshëm financiar për zhvillimin e komunës, meqë nga të hyrat e përgjithshme nuk janë mjaftueshme duke u bazuar në kërkesat sipas Drejtorive të Komunës sonë.

#### BUXHETI NGA GRANTI DHE TE HYRAT VETANAKE PER VITIN 2021-2023 SIPAS QARKORES BUXHETORE NR.2020/01

Organizata buxhetore	Aprovimi	Planifikimi	% e rritjes së buxhetit	Diferenca 2020-2021	Projeksioni	Projeksioni
	2020	2021			2020	2023
Administrata e përgjithshme	4,562,764	4,428,703	97	-134,061	4,697,291	4,990,401
Arsimi	2,902,691	3,008,426	104	105,735	3,223,811	3,238,302
Shëndetsia	1,117,392	1,187,422	106	70,030	1,814,473	1,823,545
Huamarrj Arsim, Shëndetsi						
<b>Grantet</b>	<b>8,582,847</b>	<b>8,624,551</b>	<b>100.49</b>	<b>41,704</b>	<b>9,735,575</b>	<b>10,052,248</b>
Te hyrat vetanake	462,344	462,344	100	0	504,765	538,800
<b>Totali:</b>	<b>9,045,191</b>	<b>9,086,895</b>	<b>100.46</b>	<b>41,704</b>	<b>10,240,340</b>	<b>10,591,048</b>

Në bazë të ecurive nga viti paraprake, grantet qeveritare për Komunën Dragashit si tërësi do të shënojnë rritje të letë permese rritjes se Grantit të, shëndetesise dhe i arsimit. Rritja e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht 0.46% në krahasim me vitin 2019. Sipas të dhënave të prezantuar në tabelën më lartë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për ndrushimet buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2021-2023. Rritja kryesisht është reflektuar në Grantin, Shëndetesise dhe ate të Arsimit (si në tabelen lart)

### 3.2 Parashikimi i të hyrave vetanake komunale


Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cilat të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

#### Të Hyrat e Komunës përbëhen nga:

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksa për automjete motorike
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për certifikata
- Qiraja nga objektet
- Bashkë-pagesat në arsim
- Bashkë-pagesat në shëndetësi
- Të hyra tjera<sup>1\*</sup>

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite , milion Euro:



Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rritje të ndjeshme nga viti në vit deri me 2019=500,817. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2020=500,817 , në vitin 2021 planifikohe nga qendra në 462,344 ,në vitin do të jetë një planifikim normal. 2022=504,765 dhe 2023=538,800 inkasimi i tarifave dhe ngarkesave të keti ligji që priten të inkasohen në vitet në vazhdim. Planifikimi i të hyrave në vitet në vazhdim është marr nga Qarkorja buxhetore 2021/1.

#### **Kalkulimet e Tatimit në Pronë:**

- *Vlera e Patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori zonave
- *Vlera e Kalkuluar Vjetore* - që duhet të mblidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e Pagesës Vjetore* - Pagesat për vit, duke përfshirë pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i Akumuluar dhe Pagesa e Pritur e Borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

#### **Kalkulimet e të hyrave tjera:**

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të Komunave janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe pagesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara

**Tabela 2 PARASHIKIMI I TE HYRAVE VETANAKE SIPAS VITEVE 2020-2021-2023**

Nr.	Përshkrimi	2020 Vlerësimi	2021 Vlerësimi	2022 Vlerësimi	2023 Vlerësimi
a	b	e	e	f	g
1	<b>TË HYRAT KOMUNALE TOTALE</b>	<b>9,045,191</b>	<b>9,086,895</b>	<b>10,240,340</b>	<b>10,591,048</b>
1.1	<b>TË HYRAT VETANAKE</b>	<b>462,344</b>	<b>462,344</b>	<b>504,765</b>	<b>538,800</b>
1.1.1	Tatimi në pronë	189,723	200,000	219,464	233,500
1.1.2	Tatimi në tokë	68,417	85,429	100,000	120,000
1.1.3	<b>Taksat komunale</b>	<b>93,344</b>	<b>75,055</b>	<b>79,301</b>	<b>79,300</b>
	Licencat dhe lejet (taxat e bizneseve)	10,000	10,000	12,000	12,000
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	30,000	30,000	30,000	30,000
	Taksat e pajisjeve motorike	42,000	23,711	24,000	24,000
	Lejet për ndërtesa	6,344	6,344	7,301	7,300
	Taksat tjera komunale	5,000	5,000	6,000	6,000
1.1.4	<b>Ngarkesat komunale</b>	<b>54,000</b>	<b>45,000</b>	<b>45,000</b>	<b>45,000</b>
	Ngarkesat regullatore				
	Të hyrat nga qiraja	24,000	20,000	20,000	20,000
	Bashkë-pagesat për arsim				
	Bashkë-pagesat për shëndetësi	30,000	25,000	25,000	25,000
	Ngarkesat tjera				
1.1.5	<b>Të hyrat tjera</b>	<b>16,860</b>	<b>16,860</b>	<b>20,000</b>	<b>20,000</b>
	Gjobat e gjykatave	5,000	5,000	6,000	6,000
	Gjobat e trafikut	25,000	25,000	25,000	25,000
	Agjensioni I pyjeve	10,000	10,000	10,000	10,000
1.2	<b>Shitja e aseteve</b>				
1.2.1	<b>Grantet dhe donacionet</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Vendore				
	Të huaja				
1.3	<b>TRANSFERET QEVERTARE</b>	<b>8,582,847</b>	<b>8,624,551</b>	<b>9,735,575</b>	<b>10,052,248</b>
1.3.1	<b>Granti i përgjithshëm</b>	<b>4,562,764</b>	<b>4,428,703</b>	<b>4,697,291</b>	<b>4,990,401</b>
1.3.2	<b>Granti specifik për arsim</b>	<b>2,902,691</b>	<b>3,008,426</b>	<b>3,223,811</b>	<b>3,238,302</b>
1.3.3	<b>Granti specifik për shëndetësi</b>	<b>1,117,392</b>	<b>1,187,422</b>	<b>1,814,473</b>	<b>1,823,545</b>

**3.3 LIMITET FILLESTARE SIPAS QARKORES BUXHETORE Nr.2020/01INGA  
MEF-i:**

	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Granti për administratën Komunale	4,562,764	4,428,703	4,697,291	4,990,401
Granti për Arsim	2,902,691	3,008,426	3,223,811	3,238,302
Granti për Shëndetsi	1,117,392	1,187,422	1,814,473	1,823,545
Huamarrjet në Shëndetsi dhe Arsim				
<b>Gjithsej granti nga BKK</b>	<b>8,582,847</b>	<b>8,624,551</b>	<b>9,735,575</b>	<b>10,052,248</b>
Të hyrat vetanake nga Buxheti i KK- Dragashit	462,344	462,344	504,765	538,800
<b>Totali i buxhetit Komunal- Dragashit</b>	<b>9,045,191</b>	<b>9,086,895</b>	<b>10,240,340</b>	<b>10,591,048</b>

Nga përmbledhja e shpenzimeve për KK- Dragashit shihet se për vitin 2021 janë planifikuar shpenzime prej 9,086,895 euro, sipas qarkores së parë 2021/ 01 nga MEF-i.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktualet të vitit 2020, planifikimi për vitin e ardhshëm 2021 si dhe projeksionet e vitit 2022-2023 janë gati të njejta pos pagave dhe medijtje, shpenzimeve kapitale dhe subvencionve që kanë një rritje të dukshme.

3.4 Tabela 7: Shpenzimet Komunale 2020 (këtë vit), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	2019 (këtë vit)						
	Paga Meditje	Mallra Sherbime	Shpenzime Komunali	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Rezerva	Gjithsej
Zyra e Kryetari	128,000	32,460		130,000		2,599	293,059
Zyra e Kuvendit Komunal	102,939	20,000				54,565	177,504
Administrata dhe Personeli	186,363	202,540				10,265	399,168
Buxheti dhe Financa	89,021	95,000					184,021
Sherbimet Publike	157,000	20,000	63,000			4,864	244,864
Zyra Komunale për Komunitet	33,120	12,000				299	45,419
Bujqësi, Pylltari, Inspektion dhe Zhvillim Rural	111,154	20,000				1,325	132,479
Kadastrat dhe Gjeodezia	36,648	6,000					42,648
Planifikimi Urban dhe Mjedis	53,000	6,000			2,180,430	93	2,239,523
<b>Shëndetësi dhe Mirëqenia Sociale</b>	<b>742,136</b>	<b>182,392</b>	<b>30,000</b>		<b>120,000</b>	<b>97,565</b>	<b>1,172,093</b>
Administrata	20,000	5,000				4,385	29,385
Sherbimet e Shëndetësis Primare	722,136	177,392	30,000		120,000	93,180	1,142,708
Sherbimet Sociale	55,876	10,000	3,000				68,876
Kulturë, Rini dhe Sport	65,200	45,875		30,000	50,000	5,386	196,461
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>2,825,638</b>	<b>286,641</b>	<b>34,000</b>		<b>200,000</b>	<b>502,796</b>	<b>3,849,075</b>
Administrata	51,769	40,000			200,000	238	292,007
Arsim i parashkollor	116,000					25,382	141,382
Arsimi Fillor	2,173,706	166,641	26,000			394,989	2,761,336
Arsimi i Mesem	484,163	80,000	8,000			82,187	654,350
<b>GJITHSEJ</b>	<b>4,586,095</b>	<b>938,908</b>	<b>130,000</b>	<b>160,000</b>	<b>2,550,430</b>	<b>679,757</b>	<b>9,045,190</b>



Tabela 8: Shpenzimet Komunale për (vitin e 1) 2021, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet code	Nr: pun.	Pagat	MallradheSherbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	16009	14	128,000	35,000		130,000		293,000
Zyra e Kuvendit Komunal	16909	0	103,000	20,000				123,000
Administrata dhe Personeli	16309 16509	37	195,898	223,000				418,898
Buxhet dhe Financa	17509	18	93,000	65,000				158,000
Sherbimet Publike	18413	22	139,864	20,000	63,000			222,864
Zyra Komunale për Komunitet	19545	5	33,419	12,000				45,419
Bujqësi,Pylltari,inspekcion dhe Zhvillim Rural	47009	20	112,479	20,000				132,479
Kadastra dhe Gjeodezia	65045	9	41,512	6,000				47,512
Planifikimi Urban dheMjedis	66350	8	53,093	6,000			2,122,430	2,181,523
<b>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</b>	<b>62173</b>	<b>104</b>	<b>840,316</b>	<b>163,000</b>	<b>30,000</b>		<b>209,106</b>	<b>1,242,422</b>
Administrata	73018	3	25,000	5,000				30,000
Shërbimet e Shëndetësis Primare	73550	101	815,316	158,000	30,000		209,106	1,212,422
Sherbimet Sociale	75541	10	55,876	10,000	3,000			68,876
Kulturë, Rini, Sport	85009	12	70,586	50,000		70,000	50,000	240,586
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>62192</b>	<b>518</b>	<b>3,328,434</b>	<b>336,641</b>	<b>34,000</b>		<b>213,241</b>	<b>3,912,316</b>
Administrata	92045	8	52,007	80,000				132,007
Arsimi parashkollor	92370	21	141,382					141,382
Arsimi fillor	93240	402	2,568,695	176,641	26,000		173,241	2,944,577
Arsimi i mesem	94441	87	566,350	80,000	8,000		40,000	694,350
<b>Gjithësejt €</b>		<b>777</b>	<b>5,195,477</b>	<b>966,641</b>	<b>130,000</b>	<b>200,000</b>	<b>2,594,777</b>	<b>9,086,895</b>

Tabela 9: Shpenzimet Komunale, projeksionet 2022 (vitin e 2), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet code	Nr: pun.	Pagat	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Shpenzim e Kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	16009	15	128,500	35,000		130,000		293,500
Zyra e Kuvendit Komunal	16909	0	104,000	20,000				124,000
Administrata dhe Personeli	16309 16509	37	206,500	223,000				429,500
Buxhe dhe Financa	17509	18	108,220	65,000				173,220
Sherbimet Publike	18413	22	144,371	20,000	63,000			227,371
Zyra Komunale për Komunitet	19545	5	36,569	12,000				48,569
Bujqësi, Pyltari, inspekcioni dhe Zhvillim Rural	47009	20	124,028	20,000				144,028
Kadastra dhe Gjyqësoria	65045	9	46,960	6,000				52,960
Planifikimi Urban dhe Mjedis	66350	8	54,000	6,000			2,260,901	2,320,901
<b>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</b>	<b>62173</b>	<b>104</b>	<b>950,000</b>	<b>365,000</b>	<b>30,000</b>		<b>524,473</b>	<b>1,869,473</b>
Administrata	73018	3	25,000	5,000				30,000
Sherbimet e Shëndetësis Primare	73550	101	925,000	360,000	30,000		524,473	1,839,473
Sherbimet Sociale	75541	10	56,000	10,000	3,000			69,000
Kulturë, Rini, Sport	85009	12	73,736	60,000		70,000	165,367	369,103
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>62192</b>	<b>518</b>	<b>3,384,074</b>	<b>356,141</b>	<b>34,000</b>		<b>344,500</b>	<b>4,118,715</b>
Administrata	92045	8	54,107	90,000			285,000	429,107
Arsimi parashkollor	92370	21	151,074					151,074
Arsimi fillor	93240	402	2,598,943	186,141	26,000			2,811,084
Arsimi i mesëm	94441	87	579,950	80,000	8,000		59,500	727,450
<b>Gjithësejt €</b>		<b>777</b>	<b>5,416,958</b>	<b>1,198,141</b>	<b>130,000</b>	<b>200,000</b>	<b>3,295,241</b>	<b>10,240,340</b>

Tabela 10: Shpenzimet Komunale, projeksionet 2023 (vitin e 3), të shpërndara në kategori ekonomik dhe programe

Drejtorit/Programet	Drejtori të/ Programet code	Nr: pu n.	Pagat	MallradheShe rbime	Shpenzi me Komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	16009	15	150,324	35,000		130,000		315,324
Zyra e KuvenditKomunal	16909	0	162,505	20,000				182,505
AdministratadhePersoneli	16309 16509	37	218,448	224,000				442,448
BuxhetdheFinanca	17509	18	113,470	65,000				178,470
SherbimetPublike	18413	22	146,471	20,000	63,000			229,471
Zyra KomunalepërKomunitet	19545	5	41,819	12,000				53,819
Bujqësi,Pylltari,inspektion dhe Zhvillim Rural	47009	20	129,278	20,000				149,278
KadastradheGjeodezia	65045	9	52,210	6,000				58,210
Planifikimi Urban dheMjedis	66350	8	60,443	6,000			2,367,641	2,251,901
<b>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</b>	<b>62173</b>	<b>104</b>	<b>953,000</b>	<b>375,000</b>	<b>30,000</b>		<b>518,545</b>	<b>1,876,545</b>
Administrata	73018	3	25,000	5,000				30,000
Shërbimet e Shëndetësis Primare	73550	101	928,000	370,000	30,000		518,545	1,846,545
Sherbimet Sociale	75541	10	63,226	10,000	3,000			76,226
Kulturë, Rini, Sport	85009	12	81,086	45,875		70,000	164,867	361,828
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>62192</b>	<b>518</b>	<b>3,438,840</b>	<b>380,000</b>	<b>34,000</b>		<b>380,000</b>	<b>4,415,023</b>
Administrata	92045	8	59,357	100,000			300,000	459,357
Arsimi parashkollor	92370	21	160,283					160,283
Arsimi fillor	93240	402	2,598,943	200,000	26,000			3,007,126
Arsimi i mesem	94441	87	620,257	80,000	8,000		80,000	788,257
<b>Gjithësejt €</b>		<b>777</b>	<b>5,611,120</b>	<b>1,218,875</b>	<b>130,000</b>	<b>200,000</b>	<b>3,431,053</b>	<b>10,591,048</b>

## **PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)**

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitin 2021-2023, nga ana e Kuvendit Komunal të Dragashit sipas proceseve buxhetore të zhvilluara dhe të aprovuara .

Në tabelën e më poshtme paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me buxhet të vitit 2020 me financim nga të hyrat vetanake si dhe nga mjetet e Grantit të destinuara për shpenzime kapitale .

Gjithashtu në këtë tabelë do të paraqesim edhe projektet e planifikuara për vitin fiskal 2021-2022, nga të Hyrat vetanake të parashikuara si dhe nga mjetet e Grantit për shpenzime kapitale.

Kjo listë e planifikuar për vitin 2021-2023 mund të plotësohet edhe me projekte të tjera por edhe mund të largohen disa nga planifikimi por ky plotësim dhe modifikim i projekteve mbetet për më vonë. Këto plotësime dhe modifikime mund të bëhen nga Drejtoritë përkatëse gjatë shqyrtimeve për prioritet të Investimeve Kapitale si dhe gjatë diskutimeve me Komitetin për politikë dhe financa si dhe me struktura tjera Komunale, por gjithashtu edhe në takimet me qytetarë.

Lista e Shpenzimeve Kapitale për vitin 2021-2023

Projekti sipas programeve-nëprogrameve	Projekti	Planifikimi për vit 2021			Parashikimi 2022	Parashikimi 2023
		Granti	TV	Totali		
1	Rregullimi i kanalizimit dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse në Dragash	20,000.00	5,000.00	25,000.00	20,000.00	20,000.00
2	Ndërtimi i ujësjellësit kryesor		30,000.00	30,000.00	160,000.00	160,000.00
3	Shpronësimi dhe Ekzekutimi i Vendime Gjyqësore		30,000.00	30,000.00	38,901.00	42,641.00
4	Bashtëfincimi i projektit me donator	50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00
5	Rregullimi i prorit, kubëzimi dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Rapçë projekt dy vjeçar	47,656.00	12,344.00	60,000.00	70,000.00	70,000.00
6	Rregullimi i rrjetit të ujësjellës në fshatin Rapçë	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00
7	Rregullimi i qendres së fshatit në Brod	40,000.00		40,000.00	50,000.00	60,000.00
8	Rregullimi i rruges në fshatin Brod-Vazhdimi i punimve	30,000.00		30,000.00	40,000.00	50,000.00
9	Renovimi i pusetave të ujit në fshatin Brod-Vazhdimi i punimve	15,000.00		15,000.00	25,000.00	30,000.00
10	Ndërtimi i kercave sportive në Gillobogicë	30,000.00		30,000.00	30,000.00	30,000.00
11	Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër në fshatin Gillobogicë	10,000.00		10,000.00	25,000.00	25,000.00
12	Rregullimi i shtrazit të lumit në Krushëvë	20,000.00		20,000.00	15,000.00	15,000.00
13	Rregullimi i infrastrukturës rrugore në Krushëvë	10,000.00		10,000.00	15,000.00	15,000.00
14	Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellës në Zhipotok	20,000.00		20,000.00	25,000.00	60,000.00
15	Ndërtimi i ndiqimit publik në fshatin Zhipotok	15,000.00		15,000.00	15,000.00	15,000.00
16	Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatin Zhipotok	40,000.00		40,000.00	50,000.00	60,000.00
17	Rikonstruktimi i rruges si dhe vendosja e pahive elastike mbrojtëse në Leshan projekt tre vjeçar	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
18	Hapja dhe asfaltimi i rruges Kukajian-Vitkovac projekt tre vjeçar	60,000.00		60,000.00	60,000.00	60,000.00
19	Ndërtimi i ures murit mbrojtës dhe rregullimi i prorit në fshatin Mlikë	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00
20	Kubzimi i rrugëve si dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Kerstec (i eper dhe i posh)	25,000.00		25,000.00	30,000.00	40,000.00
21	Kubëzimi i parkimeve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në Radeshtë projekt dy vjeçar	20,000.00		20,000.00	20,000.00	30,000.00
22	Ndërtimi i rezervarit të ujit në fshatin Radesh në lagjen e eper	30,000.00		30,000.00	20,000.00	25,000.00
23	Kubëzimi i rrugëve dhe infrastruktura përcjellëse në fshatin Orqushë	10,000.00		10,000.00	10,000.00	10,000.00
24	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatin Restelcë projekt dy vjeçar	50,000.00		50,000.00	25,000.00	25,000.00
25	Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellës në fshatin Vranje projekt dy vjeçar	25,000.00		25,000.00	50,000.00	50,000.00
26	Kubëzimi i rrugëve dhe rregullimi i infrastrukturës në fshatin Dikanc	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
27	Hapja e rruges bujqësore në fshatin Lubovisht	10,000.00		10,000.00	15,000.00	20,000.00
28	Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër në fshatin Lubovisht	10,000.00		10,000.00	15,000.00	20,000.00
29	Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi parkimit dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Baçkë	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00
30	Rregullimi i prorit me vendin e qalitur vranishka në fshatin Restelcë	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00
31	Asfaltimi i rruges Strazimir-Restelcë projekt tre vjeçar	80,000.00		80,000.00	100,000.00	100,000.00
32	Rregullimi i qendres së fshatit dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Restelcë	40,000.00	20,000.00	60,000.00	80,000.00	20,000.00
33	Asfaltimi i rruges Zaplluxhe-Qendra turistike	143,430.00		143,430.00	20,000.00	20,000.00
34	Kubëzimi i rrugëve të lagjeve (Rrenak, Tumpjne dhe te Gjanija) në Zaplluxhë	50,000.00		50,000.00	90,000.00	100,000.00
35	Hapja e rrugëve të fshatit Blaç (Bodza e kuqe, Rrenzave dhe ura e Haxhis) si dhe hapja e rruges për bleshk	70,000.00		70,000.00	10,000.00	10,000.00
36	Kubzimi i rrugëve në fshatin Blaç	5,000.00		5,000.00	10,000.00	10,000.00
37	Hapja, kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër në fshatin Bresanë	110,000.00		110,000.00	100,000.00	100,000.00
38	Punimi i ujësjellës hapja dhe rregullimi i shitigjeve për ecje në fshatin Bresanë	40,000.00		40,000.00	50,000.00	50,000.00
39	Kubzimi i rruges se fshatit Kuk Kapre projekt dy vjeçar	20,000.00		20,000.00	20,000.00	30,000.00
40	Asfaltimi i rruges në bleshk në fshatin Kuk projekt dy vjeçar	80,000.00		80,000.00	80,000.00	80,000.00
41	Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër në fshatin Kuklibeg	30,000.00		30,000.00	30,000.00	50,000.00
42	Hapja e rrugëve për bleshk si dhe rregullimi i rruges Kosov-Xerxe në fshatin Kosavë	25,000.00		25,000.00	30,000.00	40,000.00
43	Rregullimi i burimeve të ujit në fshatin Kosavë	5,000.00		5,000.00	10,000.00	20,000.00
44	Rregullimi (trazimi) kubzimi i rrugëve publike në fshatin Kapre	20,000.00		20,000.00	20,000.00	25,000.00
45	Rregullimi dhe renovimi i rrjetit të ujësjellës në fshatin Buzez	15,000.00		15,000.00	15,000.00	30,000.00
46	Rregullimi i pikës turistike në fshatin Zgatar	35,000.00		35,000.00	35,000.00	45,000.00
47	Kubëzimi i rruges prejë daljes së fshatit deri te lapidari në fshatin Brnut	40,000.00		40,000.00	40,000.00	35,000.00
48	Ndërtimi i ujëmbledhësve dhe infrastrukturës tjetër në fshatin Zym	12,000.00		12,000.00	12,000.00	20,000.00

49	Ndërtimi i amfiteatrit në fshatin Bellobrad	50,000.00		50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
50	Rregullimi i infrastrukturës dhe varrezave në fshatin Brezne	55,000.00		55,000.00	55,000.00	55,000.00	45,000.00
51	Rregullimi i shtuarit të ligërit dhe kenderit të lojrave në fshatin Brezne	40,000.00		40,000.00	50,000.00	50,000.00	15,000.00
52	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Buge	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00	30,000.00
53	Punimi dhe Rregullimi i rrjetit, furnizues të ujshpërcësimit në fshatin Pllavë projekt dy vjeçar	50,000.00		50,000.00	50,000.00	50,000.00	30,000.00
54	Ndërtimi i stacionit si dhe rrethojës së shkollës në fshatin Reme	30,000.00		30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
55	Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Pllajnik	15,000.00		15,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
56	Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse në fshatin Xërxe	10,000.00		10,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
57	Ndërtimi i ndriqimit në fshatin Shajne	5,000.00		40,000.00	40,000.00	35,000.00	35,000.00
58	Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës në fshatin Shajne	40,000.00		10,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00
59	Rregullimi i parkut të ri si dhe vazhdimi i punimeve të parku i vjetër në fshatin Shajne	10,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
60	Rregullimi i murit mbrojtës në rrugën Brutu-Zgatar			20,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00
61	Rregullimi i hapësirave gjelbra publike si dhe varrezave të gjyritit- projekt tre vjeçar			10,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00
62	Rregullimi i ndriqimit publik të gjyritit- projekt tre vjeçar			10,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00
63	Rregullimi rrjetit të ri të ujshpërcësimit në Dragash	7,000.00		7,000.00	10,000.00	10,000.00	20,000.00
64	Hapja dhe kubëzimi i rrugëve në Dragash	50,000.00		50,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
65	Rregullimi i trotuarve në Dragash	20,000.00		20,000.00	40,000.00	60,000.00	60,000.00
66	Renovimi i objektit të Zjarfikës në Dragash	15,000.00		15,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
	<b>Shëndësi dhe Mirëqenia Sociale</b>						
1	Ndërtimi i objektit të gendës së Mjekësisë Familjare në fshatin Krushëvë- projekt dy vjeçar	100,000.00		100,000.00	124,473.00	118,545.00	
2	Rregullimi i oborrit dhe ndërtimi i garazhade në QKMF Dragash	60,000.00		70,000.00	200,000.00	200,000.00	
3	Blejja e aparatues medicinale	39,106.00		39,106.00	200,000.00	200,000.00	
	<b>Kulturë Rini Sport</b>						
1	Bashkëfinancimi i projekteve në kulturë rinie dhe sport		10,000.00	10,000.00	20,000.00	30,000.00	
2	Ndërtimi i objekteve kulturore dhe sportive në Komunën e Dragashit	20,000.00		20,000.00	40,000.00	145,367.00	134,867.00
	<b>Arsimi dhe Shkencë</b>						
1	Ndërtimi i nryeve sanitare dhe hapësirës multi funksionare në shkollën e mesme Ruzhdi Berisha	40,000.00		40,000.00	59,500.00	80,000.00	
2	Rregullimi i rrethojës oborrit të shkollës fillore Shaban Shabani-Lapusnik	58,033.00		58,033.00	80,000.00	90,000.00	
4	Rregullimi i oborrit të shkollës fillore Sezair Surroi-Zym	8,000.00		8,000.00	20,000.00	25,000.00	
5	Punime dhe rregullimi i dyshemeve në shkollën fillore Shaban Shabani-Brezne	10,000.00		10,000.00	20,000.00	20,000.00	
6	Ndërtimi i oborrit të shkollës Fetah Sylejmani-Xërxe	5,000.00		5,000.00	30,000.00	30,000.00	
7	Rregullimi i fushës së Sportit Fetah Sylejmani në Dragash	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00	
8	Rregullimi dhe inventarizimi i kabinetit të natyres shkolla fillore Resteic	12,000.00		12,000.00	20,000.00	20,000.00	
9	Rregullimi dhe inventarizimi i kabinetit të shkencave të natyres shkolla fillore Zenuni-Brod	11,208.00		11,208.00	20,000.00	20,000.00	
10	Renovimi i shkollës fillore, 9 maji në fshatin Rapçë	12,000.00		12,000.00	20,000.00	20,000.00	
11	Renovimi i shkollës fillore Svetlost në Krushëvë vazhdimi i punimeve	12,000.00		12,000.00	20,000.00	20,000.00	
12	Rregullimi i kabineve shkencave të natyres të shkollave në komunës e Dragashit	25,000.00		25,000.00	35,000.00	35,000.00	
	<b>TOTALI</b>	<b>2,347,433</b>	<b>247,344</b>	<b>2,594,777</b>	<b>3,295,241</b>	<b>3,431,053</b>	